

## Syllabusi i lëndës

**Lënda:** Misticizmi

**Programi i studimit:** Studime Islame

**Numri i ECTS kredive:** 4

**Statusi i lëndës:** Obligative

**Kodi i lëndës:** 413

**Fondi i orëve:** 2+0

**Viti akademik:** 2026/2027

**Semestri:** VIII

**Mësimdhënësi:** Prof. ass. Dr. Abdylkader Durguti, **e-maili:** abdulkerdurguti@gmail.com

## Përshkrim i shkurtër i lëndës

Kjo lëndë do të japë një pasqyrë hyrëse në përmasat e brendshme të moralit dhe spiritualitetit siç është pasqyruar në mistikën islame të njohur edhe si sufizëm. Do të mësohet për teorinë, praktikën, historinë dhe figurat udhëheqëse në këtë fushë. Njëherit, eksplorohet roli i mistikes në Islamit popullor dhe sfidat me të cilat ballafaqohet kjo përvojë shpirtërore në botën moderne. Do të shqyrtohen tematikat më kryesore të misticizmit, që nga shumëllojshmëria e definicioneve, ritualeve dhe orientimeve, e deri te shqyrtimi i mënyrave se si shprehet Mistika Islame - në teologji, poezi dhe art. Temat në këtë lëndë përfshijnë asketizmin e hershëm, sufizmin e mesjetës dhe tarikatet e mëvonshme, sidomos ato që gjenden në trevat shqiptare. Studimi do të përmbanë definicione, botëkuptime dhe procese të zhvillimit të misticizmit, që nga paraqitja e tij e deri në ditët e sotme, si dhe raportin e kësaj lëmie me shkencat tjera, e në veçanti fokusohemi në të ngjashmet dhe dallimet ndërmjet rrymave mistike islame.

## Qëllimi i lëndës

- Pajisja e studentëve me njohuri bazë nga lëmi i Misticizmit në përgjithësi dhe atij islam në veçanti. Studenti do të hulumtojë konceptin, zanafillën dhe etapat e zhvillimit, strukturën e sajë, raportin që mbanë me shkencat tjera, botëkuptimet e ndryshme.
- Zhvillimi i shkathtësive për të analizuar të dhënat e koncepteve të ndryshme mistike të cilat përfshin programi studimor, në mënyrë që të mund të nxjerr konkluzione për to.
- Avancimi i sensit kritik në aspektin e vlerësimit të argumenteve bazuar në fakte përkatëse nga burimet islame. Për shkak se zhvillimi i mendimit mistik është një çështje e pandalshme, kërkon vëmendjen e secilit brez për të arritur njohuri sa më të shëndosha.

- Aftësimi për të shkruar ese apo për të diskutuar për tema të ndryshme mistike dhe aksiologjike, në një stil të pastër dhe bindës në të shprehurit me gojë dhe me shkrim.

### **Rezultatet e pritura të nxënies:**

#### **Pas përfundimit të kursit, studentët do të jenë në gjendje të:**

- Demonstrojnë një kuptim të temave kryesore të Misticizmit;
- Përshkruajnë proceset e zhvillimit, praktikat mbizotëruese, bindjet dhe perspektivat;
- Identifikojnë karakteristikat e mistikës islame, figurat e shquara dhe personalitetet, si dhe ndikimin që ka lëmia në disiplina të tjera.
- Krahasojnë ndërmjet rrymave të ndryshme mistike të cilat i studiojnë gjatë kursit.
- Diskutojnë rreth tematikave të mistikes në bazë të argumenteve të tyre, duke arritur në konkluzione sa më të qarta dhe objektive.
- Mbrojnë qëndrimet e rendeve të ndryshme mistike, ashtu siç i konceptuan themeluesit.
- Parashatrojnë mendimin kritik ndaj secilës prej tyre, duke përfunduar në atë me argumente më të shëndosha.
- Aplikojnë njohuritë e fituara në relacionin e tyre fetar dhe ndërsheqërorë.

### **Metodologjia e mësimdhënies:**

Mësimi do të zhvillohet në formë të ligjëratave, me anë të projektorit, i cili i ndihmon studentët që ta kuptojnë edhe më qartë ligjëratën, stimulimit të tyre në diskutime interaktive, duke bërë pyetje dhe analiza në kuadër të ligjëratës së mbajtur. Po ashtu do të mbahen seminare dhe ese të ndryshme, të cilat do të prezantohen në mënyrë individuale por edhe grupore, dhe teste të vetëvlerësimit. Gjithashtu studentët kanë mundësi që gjatë përgatitjes së lëndës të kontaktojnë me profesorin dhe të marrin udhëzime me qëllim të arritjes së cilësisë dhe rezultateve sa më të mira.

### **Përmbajtja e lëndës:**

**Java e parë:** Hyrje, Njohja me syllabusin, metoda, organizimi dhe shqyrtime të përgjithshme: *Misticizmi si dukuri mbarë njerëzore, e jo vetëm fetare.*

**Java e dytë:** Çka është Misticizmi? Çfarë e karakterizon? Dha, a dallon prej Sufizmit? *Bisedë interaktive, duke krahasuar këto koncepte njëri me tjetrin.* **Literatura:** H. Kamil Yilmaz, *Hyrje në Tesavvuf*, (f. 14-27).

**Java e tretë:** Zhvillimi historik i mistikes islame- Sufizmit: burimet, subjekti dhe qëllimi. *Diskutim rreth nevojës për misticizmin islam.* **Literatura:** H. Kamil Yilmaz, *Hyrje në Tesavvuf*, f. (f. 48-61)

**Java e katërt:** Relacioni i Mistikes Islame me fushat tjera të njohurisë. Marrëdhëniet e saj me Shkencat islame, me shkencat natyrore, si dhe me filozofinë, letërsinë dhe artet e bukura. *Propozim i temave seminarike -* **Literatura:** H. Kamil Yilmaz, *Hyrje në Tesavvuf*, (f. 51-62).

Osman Nuri Topbash, *Tasavvufi ose Mistika islame*, (f. 66-90).

**Java e pestë:** Epistemologjia frymëzuse (sufiste). Mënyrat e njohurisë në metodologjinë frymëzuese. Ontologjia. Kuptimi i ontologjisë dhe metafizikës.

*Debat rreth epistemologjisë frymëzuese dhe ndërmjet rrymave të ndryshme.*

**Literatura:** Zija Abdullahu, *Hyrje në filozofi*, (f. 68-85).

Sulejman Ulludag. *Struktura e Mendimit islam*, (f. 148-166 & 232-248).

**Java e gjashtë:** Historia e mistikes islame: tri periudhat; asketizmi, tesavvufi, tarikati.

*Bisedë interaktive rreth paraqitjes së tarikateve në trojet shqiptare.*

**Literatura:** H. Kamil Yilmaz, *Hyrje në Tesavvuf*, (f. 65-123).

**Java e shtatë:** Terminologjia e Mistikes islame; termat morale.

*Testi i parë.*

**Literatura:** H. Kamil Yilmaz, *Hyrje në Tesavvuf*, (f. 129-151)

**Java e tetë:** Terminologjia e mistikes islame; termat e etikes në mësimnxënie sufite.

*Analizimi i rezultateve të testit të mbajtur.*

*si dhe debat rreth pikëpamjeve të besëdhënies në rryma të ndryshme sufite.*

**Literatura:** H. Kamil Yilmaz, *Hyrje në Tesavvuf*, (f. 152-167).

**Java e nëntë:** Terminologjia e mistikes islame; termat e gjendjes shpirtërore dhe njohjes.

**Literatura:** H. Kamil Yilmaz, *Hyrje në Tesavvuf*, (f. 168-190).

**Java e dhjetë:** Institucionet e mistikes islame; teqet dhe zavijet.

**Literatura:** H. Kamil Yilmaz, *Hyrje në Tesavvuf*, (f. 190-230).

**Java e njëmbëdhjetë:** Mistika islame në Ballkan Depërtimi dhe marrëdhëniet shoqërore.

*Bisedë rreth kontributit të tyre në mistikë dhe shkenca tjera islame.*

**Literatura:** Metin Izeti, *Kllapia e Tesavvufit*, (f. 85-115 & 196-206)

**Java e dymbëdhjetë:** Mistika islame në Ballkan: Rrymat përfaqësuese (Tarikatet).

*Përsëritje nga orët e mëparshme.*

**Literatura:** Metin Izeti, *Kllapia e Tesavvufit*, (f.116-195)

**Java e trembëdhjetë:** Çështje të mendimit dhe praktikës mistike islame: Qenësia, dija dhe njeriu. Tevessuli, Teberruki, Kerameti, Rabita dhe vizita e varreve.

**Literatura:** H. Kamil Yilmaz, *Hyrje në Tesavvuf*, (f. 231-250 & 251-269).

**Java e katërbëdhjetë:** Ihsani: rrënjët kuranore, nivelet e ngritjes dhe manifestimi i tij.

**Literatura:** S. Murata dhe W. Chittick. *Vizioni i Islamit*, (f. 369-423).

**Java e pesëmbëdhjetë:** Pozitivët dhe kritikët rreth mistikes islame.

**Literatura:** Sulejman Ulludag. *Struktura e Mendimit islam*, (f. 166-200).

Mustafa Kara, *Qëndrimet e Ibn Tejmijjes rreth Ibn Arabiut*.

Provimi përfundimtar.

**Kriteriumi dhe komponentët e vlerësimit:**

Pjesëmarrje dhe angazhimi në ligjeratë 10%  
Punimi seminarik 20%  
Testi intermedier 30%  
Provimi final 40%  
Total 100%

**Literatura obliguese:**

1. H. Kamil Yilmaz, *Hyrje në Tesavvuf*. Tetovë: 2002.
2. Metin Izeti. *Kllapia e Tesavvufit*. FSHI, Shkup: 2004.
3. Sulejman Ulludag. *Struktura e Mendimit islam: selefizmi, kelami, tesavvufi, filozofia*. Ali Pajaziti (përkth.), Shkup: Logos-A, 2009. (f. 141-200 dhe 232-248).
4. Zija Abdullahu, *Hyrje në filozofi*. (f. 68-85).
5. Sachiko Murata dhe William C. Chittick. *Vizioni i Islamit*. Prof. dr. Sokrat Ahmetaj (përkth.), London - New York, I.B. Tauris & CO Ltd, 1994. (f. 369-423).

**Literatura konsultative:**

1. Martin Lings. Çfarë është sufizmi? Edin Lohja (përkth.), Shkup: Logos-A, 2010. <https://www.logos-a.com/online/book/74/read>.
2. Selçuk Eraydin. *Tesavvufi dhe tarikatet*. Metin Izati (përkth.), Tetovë: 2001.
3. Sejjid M. Nakib el-Attas. *Hyrje në metafizikën e Islamit: paraqitje e elementeve themelore të botëkuptimit islam*. Urim Poshka (përkth.), Shkup: Logos-A, 2011.
4. Muhammed el-Gazali. *Arti i dhikrit dhe i lutjeve të peygamberit të fundit*. Sadush Tahiri (përkth.), Shkup: Logos-A, 2008.
5. William C. Chittick. *Kërkime për zemrën e humbur*. Sokrat Ahmetaj (përkth.), Tiranë: Eneas, 2012.
6. Fazlur Rrahman. *Islami*. Eqrem Kryeziu (përkth.), Shkup: Logos-A, 2010.
7. Annemarie Schimmel. *Sufism*. Encyclopædia Britannica. Encyclopædia Britannica Online. <https://www.britannica.com/topic/Sufism>.
8. Lloyd Ridgeon. *The Cambridge companion to Sufism*. US: Cambridge University Press, 2015.
9. John O. and Kazuo Ohtsuka. Sufism. In *The Oxford Encyclopedia of the Islamic World*. *Oxford Islamic Studies Online*, <http://www.oxfordislamicstudies.com/print/opr/t236/e0759>.
10. William C. Chittick. *Sufism-A beginner's guide*. Oxford, oneworld pub.: 2008.
11. Alexander Knysh. *Islamic Mysticism: A Short History*. Brill: 2000.
12. Eric Geoffroy. *Introduction to Sufism: the Inner Path of Islam*. Bloomington: World Wisdom, 2010.
13. Carl W. Ernst. *Sufism: An Introduction to the Mystical Tradition of Islam*. Boston: Shambhala, 2011.
14. Robert Frager, James Fadiman and Huston Smith. *Essential Sufism*. New York: HarperOne, 1999.

15. Llewelyn Vaughan-Lee. *Sufism: The Transformation of the Heart*. New York: The Golden Sufi Center, 1995.
16. Nile Green. *Sufism: A Global History*. Hoboken: Wiley-Blackwell, 2012.
17. Mustafa Kara, *Qëndrimet e Ibn Tejmijes rreth Ibn Arabiut*, (përktheu: Samet Vata), Lpgos-A, Shkup, 2019.
18. Ali Al Xhifri, *Udhëtarët drejt Zotit*, (përktheu: Sabina Fejzullaj (Tufa)), Shoqata kulturore “Gruaja”, Tiranë, 2007.